

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: bashkiahimare@yahoo.com
Nr Prot 2284 Himare: 31/07/2017

Lenda: Kerkese e perseritur (pas konsiderimit te shkreses Suaj me nr.prot.409/03 me date 20.04.2017 mbi kontrollin e perputhshmerise se dokumenteve te Planit te Pergjithshem Vendor), per leshimin e Aktit te Perputhshmerise per draft-planin perfundimtar te Planit te Pergjithshem Vendor te bashkise Himare.

Drejtuar: Znj.ADELINA GRECA

Drejtoresh e pergjithshme
AGJENCIA KOMBETARE E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

TIRANE

E nderuar zj.Greca,

Duke shprehur konsideraten tone per Impenjimet Tuaja te deritanishme si dhe bashkepunimit te sukseshem te dy Institucioneve, referuar shkreses Suaj me nr.prot.409/03 me date 20.04.2017 mbi kontrollin e perputhshmerise se dokumenteve te Planit te Pergjithshem Vendor, Ju veme ne dijeni se :

Mbeshtetur ne ligjin 107/2014 date 1.10.2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar me ligjin nr.28/2017 date 23.03.2017 ,VKM-te perkatese dhe rregulloret e ligjit, Bashkia Himare ka qene korrekte ne angazhimin e marre permes Akt-Marreveshjeve per hartimin dhe finalizimin e P.P.V-se.

Bashkia Himare me konsulentet perkates te Planit, ka reflektuar lidhur me komentet e bera nga Ana Juaj dhe i ka pasqyruar ne dokumentet perfundimtare te Draft-Planit . Draft Plani i Ri me te gjithë komponentet perkates eshte hedhur ne Regjistrin e Integruar te Territorit (RIT).

Ky dokument perfundimtar i rishikuar eshte ne perputhje te plote me Ligjin 107/2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe VKM 671 "Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit".

Cdo material i cili eshte pjese e hartimit te ketij Plani duke filluar qe nga marrja e nismes se Kryetarit e cdo dokument i metejshem eshte uploaduar ne R.I.T me rigorozitet duke patur parasysh komunikimin midis NJ.Q.V-se sone dhe Institucionit Tuaj, per procedurat e hartimit te «Dokumentit te Planifikimit», i cili eshte kryer permes portalit te Regjistrit te Integruar te Territorit, ky edhe si detyrim ligjor qe rrjedh nga ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i percaktuar ne germen b pika 1 te nenit 54 si dhe ne piken 1 germen a,b,c pika 2,3,4 te


nenit 56 "Botimi ne Regjister", sipas procedures se botimit te saj ne kete regjister. Bashkia Himare ka botuar plotesisht dokumentacionin e P.P.V-se ne Regjistrin e Integruar te Territorit ne koordinim sipas marreveshjes se bashkepunimit ndermjet Ministrise se Zhvillimit Urban dhe Bashkise Himare dhe konsulentit :Deastudio, Thymio Papayannis associates sa, per "Hartimin e Planeve te Pergjithshme Vendore per bashkite: Vlore, Himare, Sarande, Konispol" me nr.prot.2024/2 me date 13.04.2016.

Deklarata Mjedisore e PPV-se per Vleresimin Strategjik Mjedisor eshte marre dhe eshte pasqyruar ne shkresen me nr.prot.2307/3 me date 11.04.2017.

Gjithashtu kemi realizuar shkresen zyrtare me nr.prot.720 me date 15.05.2017 drejtuar Institucionit Tuaj per marrjen e Aktit te Perputhshmerise si kerkese per leshimin e Aktit te Perputhshmerise per draftin e Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Himare dhe jemi ne pritje te miratimit te Aktit te Perputhshmerise nga Ana Juaj ne menyre qe te vazhdojme proceduren.

Si perfundim, theksojme se me te marre pergjigjen nga Ana Juaj lidhur me Aktin e Perputhshmerise, Bashkia Himare eshte ne gatishmeri te plote per te miratuar Planin e Pergjithshem Vendor ne Keshillin Bashkiak e me tej ne Keshillin Kombetar te Territorit.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin dhe koordinimin me korrektesi ne hartimin e ketij Plani, mbetemi ne pritje te pergjigjes Tuaj.



Jorgo Goro
KRYETAR

